ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr. i Prokurimit[1]	**651-24-11957-1-1-1**
Nr i brendshëm	**GL 651 24 58 121**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me tabela të mençura për shkollat e mesme në Komunën e Gjilanit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INFINITT SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.28 Nentori, no.121
(Adresa)

Prishtinë — *10.000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/974-590 — */*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Astrit Uka- menaxher
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë

infinitt.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)



13.11.2026.
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____/_____
(Emri i avokatit)

_____/_____
(Adresa e plotë)

_____/_____ _____/_____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____/_____
(Adresa elektronike)

_____/_____ _____/_____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate: 14.11.2024.
Afati i fundit për dorzimin e ofertav: 18.03.2025.
Data dhe ora e hapjes se ofertav: 18.03.2026. ora 12:00
Njoftimi mbi vendimin e AK ku eshte rekomanduar per kontrate kompania jone si oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet: 13.05.2025.
Pas dorezimit te kerkeses per ri-shqyrtim nga OE tjere aplikues ne kete procedure lenda eshte kthyer ne ri-vleresim.
Njoftimi mbi vendimin e AK sipas te cilit AK ka rekomaduar anulimin e aktivitetit te prokurimit eshte nxjere me 23.10.2026.
Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

Procesverbalin e hapjes se ofertave e kemi pranuar ne e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Letren standarde per tenderuesin e eleminuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 23.10.2026.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi paraqitur me 28.10.2026. Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar 03.11.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 52.3- Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës Neni 56.3- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave Neni 59.2- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 70- Standardet për Sigurimin e Cilësisë Neni 72.3- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Neni 40 i Rregullores per prokurim publik- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve. Neni 10.1 i UOPP-se/ Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik.
AK/zyra e prokurimit me 23.10. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit ku ne mbeshtetje te nenit 62 te LPP-se eshte vendosur qe te anulohet aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se asnje prej ofertuesve nuk jane te pergjegjshem.
Kompania jone eshte eleminuar me arsyetimin, citoj:

Ndersa OE ne oferten e tij I ka të dorzuar sic jane kerkuar sipas DT dhe Njoftim për Kontrat ku , por të gjitha Certifikat e ISO-ve te dorzuar ne ofert jane me afat të skaduar.

Nuk qendron konstatimi i Autoritetit kontraktues se certifikatat e dorezuara per kete aktivitet te prokurimit kane skaduar.
Ne dosjen e tenderit tek kriteri nr.3 lidhur me kapacitetin teknik&profesional jane kerkuar certifikatat:
OE duhet te ofroj deshmi se eshte I certifikuar me Certifikaten ISO 9001: 2015 Certifikaten ISO 14001: 2015 dhe Certifikaten ISO 20000 -1 Për teknologji të Informacionit
Data e fundit per ofertim ka qene me 18.03.2025. dhe certifikatat e dorezuara kane vlefshmerine si ne vijim:
Certifikata ISO 9001 deri me 07.09.2026.
Certifikata ISO 14001 deri me 19.01.2026.
Certifikata ISO 20001 deri me 07.09.2026.
Prandaj nuk qendron konstatimi i AK se certifikatat e dorezuara per kete aktivitet te prokurimit kane skaduar, citoj faktin se pas skadimit te certifikatave me 19.01.2026. perkatesisht 07.09.2026. ne kemi bere vazhdimin/ripertrirjen e tyre.
Edhe sot reth 18 muaj pas ofertimit per projektin ne fjale kompania jone eshte e certifikuar me ISO standarde 9001, 14001 dhe 20001
Poashtu sipas kerkeses tek kriteri nr. 8 ne dosjen e tenderit eshte kerkuar:

Kerkesa 8. Prodhuesi duhet te jetë I certifikuar me standardet : CE Certificate, CB Certificate

ISO 9001:2015 Certificate

ISO14001:2015 Certificate

ISO 45001:2018 Certificate

ISO 27001:2013 Certificate

Deshmia 8. Kopja e certefikatave me validitet për vitin 2024 të verifikuara me link zyrtar në website zyrtar, vlen per pozicionet 3, 4, 5, 6, 9

Certifikata ISO 9001 me vlefshmeri deri me 14.06.2026.
Certifikata ISO 14001 me vlefshmeri deri me 14.06.2026.
Certifikata ISO 45001 me vlefshmeri deri me 28.10.2026.
Certifikata ISO 27001 me vlefshmeri deri me 06.05.2025.
Ndersa CE, CB certifikatat Rohs dhe te tjera nuk kane skadence pasiqe njehere prodhuesi certifikohet me keto standarde.
Mare parasysh keto fakte konstatojme se te gjitha certifikatat kane qene valide deri ne momentin e ofertimit siq kerkohet ligjerisht, nder te tjera per certifikatat e prodhuesit AK ka kerkuar qe te jene valide per vitin 2024 kur eshte publikuar aktiviteti i prokurimit.
Neni 29.1 i dosjes se tenderit parashikon mundesine e sqarimit te certifikatave, citoj:
29.1- Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga secili Tenderues individualisht sqarim mbi tenderin e tij/saj. **Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili Tenderues për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP. Megjithate, sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve**, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Secili sqarim qe dorëzohet nga tenderuesi në lidhje me tenderin e tij dhe që nuk është ne përputhje me kërkesën nga autoriteti kontraktues nuk do të konsiderohet.
Poashtu sipas nenit 72.3 te LPP-se sqarimi i dokumenteve aplikohet/pranohet per dokumentet ekzistenca e te cilave eshte e fiksuar para dates se ofertimit, citoj:
72.3- Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.
Si dhe konform nenit 59.2 te LPP-se:

> -Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. **Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen** nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Pasiqe per qeshtje te njejta jane nxjere vendime te OSHP-se citojme dhe bashkengjesim vendimet e PSH nr. 119/2026 dhe 1277/2025.
Autoriteti kontraktues ne vendimin per anulimin e aktivitetit te prokurimit ka cekur nenin 62.1 te LPP-se, citoj:

- Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Kjo dispozite ligjore nuk gjen zbatim ne kete rast, pasiqe nje shkelje e tille parashihet te kete ndodhur ne dokumentet e tenderit apo paramasen dhe ne pamundesi te korigjohet eshte e domosdoshme qe te anulohet aktiviteti i prokurimit, ne kete projekt nuk ka zbatim ligjor dispozita e cekur ne njoftimin mbi vendimin per anulim.
Poashtu per qeshtjen e njejte i jemi drejtuar KRPP-se me 30.10.2026. per interpretim ligjor dhe me 11.11.2026. kemi pranuar interpretimin e KRPP-se ku jane cituar dispozitat ligjore te lartecekura per pranimin dhe sqarimin e certifikatave dhe dokumenteve tjera te paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP.
Prandaj duke u bazuar ne argumentet ligjore konstatojme se:
Së pari, autoriteti kontraktues duhet të vlerësojë nëse kriteret kualifikuese janë përmbushur në afatin e fundit për dorëzimin e ofertave.

Së dyti, skadimi i certifikatave gjatë një procedure të zgjatur rivlerësimi nuk dëshmon vetvetiu se operatori ka qenë i papërgjegjshëm në momentin e ofertimit po te ishte ndryshe do te vie ne shprehje qe pas ri-vleresimit te kete ndryshim te kritereve te parashtruara ne DT dhe nuk ben te krijohet nje standard i tille pasiqe do te paraqitet anshmeri dhe jo trajtim i barabarte per OE aplikues.
Së treti, certifikatat e rinovuara do të paraqiten si dokumentacion mbështetës për të dëshmuar vazhdimësinë e certifikimit, jo për të krijuar në mënyrë retroaktive një kualifikim që nuk ka ekzistuar në datën e ofertimit.
Së katërti, Neni 29.1 i dosjes së tenderit lejon sqarimin e certifikatave dhe dokumenteve, ekzistenca e të cilave mund të verifikohet objektivisht para afatit të ofertimit.
Citoj faktin se kjo qeshtje ka qene ne hetim penal dhe trajtim nga Prokuroria themelore ne Gjilan dhe pas nje viti hetime rasti eshte mbyllur pasiqe nuk eshte gjetur asnje paregullesi ne certifikatat e dorezuara ne kete projekt.
Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka eleminuar pa te drejte oferten e kompanise sone megjithese kemi plotesuar te gjitha kriteret e paraqitura nga AK ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhe deri tek anulimi i aktivitetit te prokurimit pa baze ligjore, kompanise sone si oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet ne kete aktivitet te prokurimit i eshte mohuar e drejta e fitimit te paramenduar nga kjo kontrate si dhe jane shkaktuar dem i konsiderueshem financiar per shkak te sterzgjatjes se procedures se vleresimit dhe vazhdimit te vlefshmerise se sigurimit te ofertes per disa here si dhe pritshmerive per fitimin e paramenduar nga kjo kontrate.
Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*